



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.06.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen: Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i vendimit nr. 730, datë 30.5.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarkun Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Luan Rama si dhe verifikimi i mandatit të deputetit, z. Ramazan Gjuzi.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Vasilika Hysi, Musa Ulqini, Nimet Musaj, Klotilda Bushka, Myslym Murrizi, Ermonela Felaj

Mungojnë:

Ulsi Manja, Damian Gjiknuri, Alban Zeneli

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Fillojmë mbledhjen e sotme të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është depozituar në Kuvend vendimi për dhënien e mandatit të deputetit të kandidatit të listës shumëemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në qarkun Tiranë.

Në mbështetje të nenit 13 të Rregullores, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin verifikon mandatin e deputetit, i cili zgjidhet gjatë legjislaturës dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 30 ditëve. Kandidati që ka fituar mandatin e deputetit është konkretisht:

- Z. Ramazan Gjuzi, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 730, datë 30.05.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Tiranë.

Është njoftuar kandidati Ramazan Gjuzi për të qenë prezent në këtë mbledhje dhe për të shprehur nëse pranon të bëjë betimin në seancën pasardhëse në zbatim të vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Gramoz Ruçi – Zoti Ramazan pranoi ta bëni betimin në seancë?

Ramzan Gjuzi – Po, pranoj.

Gramoz Ruçi – Ju faleminderit! Kaq ishte.

Të enjten jeni të ftuar në orën 10:00, të merrni pjesë në seancën e Kuvendit. Pika e parë e rendit të ditës do të jetë betimi që ju do të bëni në Kuvend që të filloni ushtrimin e mandatit tuaj. Faleminderit dhe suksese paraprakisht.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin e mësipërm, nr. 730, i ka dhënë mandatin e deputetit kandidatit vijues të listave respektive. Vendimin e keni të gjithë përpara. A ka ndonjë mendim, ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim nga anëtarët e Këshillit, në lidhje me mandatin e deputetit të ri?

Atëherë, jemi dakord!

Anëtarët e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin janë dakord me vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush do ta lexojë raportin nesër në seancë? Z. Musa Ulqini ta lexojë në seancë raportin, siç është rregulli, i cili shpreh këtë qëndrim të Këshillit.

Mirupafshim!

Mbledhja mbyllet.

MBLEDHJA MBYLLET